

MARRËVESHJE

për bankë mbështetëse të tregut valutor në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Lidhur midis:

1. BANKËS POPULLORE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT me seli në bul. "Kuzman Josifovski – Pitu" nr.1, 1000 Shkup, e përfaqësuar nga guvernatori i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme: Banka Popullore) dhe

2. _____ me seli në _____, përfaqësuar nga _____ e bankës (në tekstin e mëtejme: banka mbështetëse).

I. LËNDA E MARRËVESHJES

Neni 1

Lënda e kësaj Marrëveshjeje është rregullimi i të drejtave dhe detyrimeve të ndërsjella ndërmjet Bankës Popullore dhe bankës mbështetëse, ndërmjet bankave mbështetëse dhe ndërmjet bankës mbështetëse dhe bankave të tjera.

Neni 2

Banka Popullore blen dhe shet euro vetëm me bankën e cila i plotëson kushtet për të qenë bankë mbështetëse sipas Vendimit për mënyrën dhe kushtet e blerjes dhe shitjes së mjeteve të huaja pagesore.

Neni 3

Dispozitat nga neni 2 i kësaj marrëveshjeje nuk zbatohen në kushte të mosbalancimit më të madh midis ofertës dhe kërkesës në tregun valutor, e cila manifestohet si rezultat i lëvizjeve të pafavorshme në bilancin pagesor ose si rezultat i tërheqjes së depozitave në valutë nga klientët e bankave.

Neni 4

Banka mbështetëse, me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, pranon të bashkëpunojë me Bankën Popullore në ruajtjen e likuiditetit dhe stabilitetit të tregut valutor në Republikën e Maqedonisë, në mënyrën dhe kushtet e përcaktuara me këtë marrëveshje.

Neni 5

Për qëllimet e kësaj marrëveshjeje, termat e përdorur kanë kuptimet e mëposhtme:

"tregu valutor" është shit-blerjeja e eurove ndërmjet Bankës Popullore dhe bankës mbështetëse, midis bankave mbështetëse dhe ndërmjet bankës mbështetëse dhe bankave të tjera.

"Banka mbështetëse" është banka e cila i plotëson kushtet e parapara në Vendimin për mënyrën dhe kushtet e blerjes dhe shitjes së mjeteve të huaja pagesore;

"bankë tjetër" është banka që nuk është bankë mbështetëse.

II. KUOTIMI I KURSIT TË BLERJES DHE SHITJES

Neni 6

Banka mbështetëse kuotonkurs të blerjes dhe shitjes për euro, duke zbatuar marzhe maksimale midis kursit të blerjes dhe shitjes.

Neni 7

Banka mbështetëse në platformën elektronike të tregtimit, në mënyrë të vazhdueshme kuoton dhe ripërtërin kuotat e kursit të blerjes dhe shitjes çdo ditë pune, nga ora 9 deri në orën 16.

III. SHIT-BLERJA E EUROVE MES BANKËS POPULLORE DHE BANKËS MBËSHTETËSE

Shit-blerja e eurove "spot" ndërmjet Bankës Popullore dhe bankës mbështetëse **Neni 8**

Banka mbështetëse, me kërkesë të Bankës Popullore, kuoton kurs të blerjes dhe shitjes për euron, me diferencë maksimale ndërmjet kursit të blerjes dhe shitjes prej 0,05 denarë për 1 euro, ndërsa kuotimet i referohen shumave prej së paku 500.000 euro.

Transaksionet kryhen sipas kurseve të këmbimit të kuotuar nga banka mbështetëse.

Neni 9

Banka Popullore kuoton kursin e blerjes dhe shitjes së euros, ku kuotat i referohen shumave të paktën 500.000 euro.

Transaksionet kryhen sipas kursit të këmbimit të kuotuar nga Banka Popullore.

Transaksionet "swap (të zëvendësimit)" ndërmjet Bankës Popullore dhe bankës mbështetëse

Neni 10

Banka Popullore do të mundësojë transaksione dypalëshe të "swap-it" të euros bankës mbështetëse që ka nevoja likuiditeti.

Banka mbështetëse mundet që me transaksion spot të shesë/blejë euro sipas kursit të kuotuar të blerjes/shitjes së Bankës Popullore dhe përsëri të blejë/shet të njëjtën shumë euro në Bankën Popullore me kursin e ardhshëm të shitjes/blerjes në ditën e maturimit.

Neni 11

Kursi i këmbimit "forward" i Bankës Popullore llogaritet duke zbatuar interesin në nivel të normës së interesit për blerjen e letrave me vlerë në baza të përkohshme - transaksione repo të reduktuar me normën e interesit që Banka Qendrore Europiane paguan për fondet e depozituara në të.

Kursi i blerjes "forward" i Bankës Popullore llogaritet duke zbatuar normën e interesit të depozitave të disponueshme për shtatë ditë në Bankën Popullore, e reduktuar me normën mesatare të interesit të tarifuar nga Banka Qendrore Europiane gjatë operacioneve të rifinancimit sipas ankandit të fundit të mbajtur.

Shuma minimale e këtyre transaksioneve është 500,000 euro, me afat maturimi 7 ditë.

IV. SHIT-BLERJA E EUROVE MIDIS BANKAVE MBËSHTETËSE

Shit-blerja e eurove në vend midis bankave mbështetëse Neni 12

Banka mbështetëse e kuoton kursin e blerjes dhe shitjes së euros për bankat tjera mbështetëse, me një diferencë maksimale prej 0,05 denarë për 1 euro ndërmjet kursit të blerjes dhe shitjes, ndërsa kuotat i referohen shumave prej së paku 350.000 euro.

Neni 13

Banka mbështetëse, me kërkesë të një banke tjetër mbështetëse, kuoton kurs të blerjes dhe shitjes për euron me marzh maksimal dhe për shumë minimale në pajtueshmëri me nenin 12, ku transaksionet realizohen sipas kursit të këmbimit të kuotuar nga banka mbështetëse.

Transaksionet "swap" dhe "forward" ndërmjet bankave mbështetëse

Neni 14

Banka mbështetëse me kërkesë të një banke tjetër mbështetëse kuoton dhe lidh transaksione "forward" ose "swap".

Kursi i këmbimit "spot" për transaksionet "swap" përcaktohet sipas kurseve të kuotuar të këmbimit për euron në pajtim me nenin 12, dhe kursi i këmbimit të ardhshëm përcaktohet me marrëveshje ndërmjet palëve kontraktuese. Transaksionet "forward" dhe "swap" në pajtim me paragrafin (1) i referohen shumave prej së paku 350,000 euro dhe realizohen me kurset e kuotuar të këmbimit.

V. SHIT-BLERJA E EUROVE MIDIS BANKËS MBËSHTETËSE DHE BANKËS TJETËR

Neni 15

Banka mbështetëse kuoton kursin e blerjes dhe shitjes për euron bankave të tjera, me diferencë maksimale prej 0,25 denarë për 1 euro ndërmjet kursit të blerjes dhe shitjes, ku kuotat i referohen shumave prej së paku 30.000 euro.

Neni 16

Banka mbështetëse, me kërkesën e një banke tjetër, kuoton kursin e blerjes dhe shitjes për euron me marzh maksimal dhe për shumë minimale në pajtim me nenin 15, ku transaksionet kryhen sipas kursit të këmbimit të kuotuar nga banka mbështetëse.

VI. MOSPLOTËSIMI I DISPOZITAVE TË MARRËVESHJES

Neni 17

Mosplotësim i dispozitave të kësaj marrëveshjeje konsiderohet atëherë kur:

- Banka mbështetëse nuk vepron në pajtueshmëri me dispozitat e marrëveshjes;
- Banka mbështetëse nuk njofton në mënyrën e përcaktuar me Udhëzimin për mënyrën e dorëzimit të të dhënave për transaksionet e kryera në tregun valutor.

Neni 18

Banka Popullore mundet përkohësisht, për një periudhë jo më të gjatë se 3 muaj, ta përjashtojë bankën mbështetëse nga shit-blejra e valutave të huaja me Bankën Popullore, nëse banka mbështetëse nuk i përmbush dispozitat e kësaj marrëveshjeje.

VII. PËRFUNDIMI I VLEFSHMËRISË SË MARRËVESHJES

Neni 19

Kjo marrëveshje është lidhur për periudhë të pacaktuar.

Palët kontraktuese kanë të drejtë të ndërpresin marrëveshjen me njoftim të ndërsjellë me shkrim, me periudhë njoftimi prej një muaji.

VIII. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 20

Banka Popullore, në pajtim me bankën mbështetëse dhe në varësi të kushteve të tregut të këmbimit valutor, ka të drejtë të nis ndryshime në dispozitat e kësaj marrëveshjeje.

Neni 21

Palët kontraktuese do t'i zgjidhin mosmarrëveshjet në mënyrë miqësore. Në rast kontesti kompetente është Gjykata Themelore Shkup 2 Shkup.

Neni 22

Kjo marrëveshje nënshkruhet në 4 (katër) kopje identike, nga të cilat 2 (dy) kopje janë për secilën nga palët kontraktuese.

**Banka Popullore e
Republikës së Maqedonisë
së Veriut**

Guvernator
